



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0140

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi Brajshori dhe Batisha Ibrahim - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “AUTOTRADE” SH.P.K., kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të “POLICIA E KOSOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIMI ME PJESE PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150 -Ri-tender” me numër të prokurimit 214-24-9697-1-1-1, me 16/04/2025, mori:

Vendim

- 1. Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE “AUTOTRADE” SH.P.K. me nr. 2025/0140, e datës 27/02/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIMI ME PJESE PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150 -Ri-tender” me numër të prokurimit 214-24-9697-1-1-1.
- 2. Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “POLICIA E KOSOVËS”, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “FURNIZIMI ME PJESE PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150 -Ri-tender” me numër të prokurimit 214-24-9697-1-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “AUTOTRADE” SH.P.K. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.09.2024, "POLICIA E KOSOVËS" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "FURNIZIMI ME PJESË PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150 -Ri-tender" me nr. të prokurimit: 214-24-9697-1-1-1. Ndërsa me datën 18.02.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 500,000.00 €.

Me 21.02.2025, OE "AUTOTRADE" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 21.02.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27/02/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "AUTOTRADE" SH.P.K. me nr. 2025/0140 për lidhur me aktivitetin "FURNIZIMI ME PJESË PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150 - Ri-tender" me nr. të prokurimit: 214-24-9697-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/1195 i dt: 28.01.2025.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AUTOTRADE" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim: Njoftimi për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 17.09.2024, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 17.10.2024, ku kanë ofertuar 2 kompani.

Me dt. 19.11.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa" ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

Me dt.23.11.2025 kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe më pastaj ankesë në OSHP me dt.10.12.2024

Ekspertiza e ekspertit shqyrtues ishte lëshuar me dt.22.12.2024 2024/1195 ku ishte aprovuar ankesa si e bazuar dhe ishte rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim, kurse vendimi i OSHP-së ishte lëshuar me dt.28.01.2025 nr. 2024/1195, ku ishte aprovuar ankesa si e bazuar dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim duke konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Gjatë rivlerësimit AK-së me dt.10.02.2025 na ka kërkuar sqarime si në vijim:

1. Duke ju referuar neni 4 të rregullores për prokurim publik pikës 4.1 c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është me i larte se çmimi i tregut ne ofertën luaj te dorëzuar keni ofruar çmime me të larta, për la vlerësuar trajtuar drejt ofertën tuaj ju lutem na dërgoni sqarime se si keni ardhur deri tek formulimi i këtyre çmimeve për pozicionel ne vijim:

Pjesa A: Pz.1, Pz.3, Pz.9, Pz.10, Pz.11, Pz.12, Pz.13, Pz.14, Pz.15, Pz.20.

Pjesa B: Pz.25, Pz.29, Pz.32, Pz.33, Pz.35, Pz.36, Pz.41, Pz.42, Pz.43, Pz.46, Pz.50, Pz.51,

Pz.52, Pz.59, Pz.60, Pz.68, 89, Pz.90, Pz.99, Pz.100, Pz.101, Pz.102, Pz.105, Pz.106, Pz.107, Pz.112, Pz.113, Pz.114, Pz.129, Pz.132, Pz.133, Pz.135, Pz.137, Pz.140, Pz.141, Pz.143, Pz.144, Pz.145, Pz.147, Pz.148, Pz.150, Pz.154, Pz.157.

Pjesa C: Pz.159, Pz.160, Pz.162, Pz.163, Pz.164, Pz.166, Pz.167, Pz.171, Pz.172, Pz.175, Pz.176, Pz.177, Pz.178, Pz.182, Pz.185, Pz.188, Pz.189, Pz.190, Pz.191, Pz.200, Pz.201, Pz.202, Pz.203, Pz.204, Pz.205, Pz.210, Pz.211, Pz.218, Pz.220, Pz.228, Pz.229

Përgjigjen e juaj sqamcse duhet ta ngarkoni në e-prokurimin më se largu 5 dite nga praninë e kësaj letre standarde.

Ne me dt. 13.02.2025 i kemi kthyer përgjigje me sqarimet si më poshtë:

Pas rivlerësimit është nxjerr njoftimi mbi vendimin me dt. 18.02.2025, ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa neve tani na dërgohet letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

OE është i papërgjegjshëm për pikat ne vijim:

- Sipas neni 4.1 pikës C të rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik cila thotë Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shumë herë me te lart se sa çmimet realo te tregut për artikullin.

- Pjesa A: Pz.1, Pz.3, Pz.9, Pz.10, Pz.11, Pz.12, Pz.13, Pz.14, Pz.15, Pz.20.

- Pjesa B: Pz.25, Pz.29, Pz.32, Pz.33, Pz.35, Pz.36, Pz.41, Pz.42, Pz.43, Pz.46, Pz.50, Pz.51, Pz.52, Pz.59, Pz.60, Pz.68, 89, Pz.90, Pz.99, Pz.100, Pz.101, Pz.102, Pz.105, Pz.106, Pz.107, Pz.112, Pz.113, Pz.114, Pz.129, Pz.132, Pz.133, Pz.135, Pz.137, Pz.140, Pz.141, Pz.143, Pz.144, Pz.145, Pz.147, Pz.148, Pz.150, Pz.154, Pz.157.

- Pjesa C: Pz.159, Pz.160, Pz.162, Pz.163, Pz.164, Pz.166, Pz.167, Pz.171, Pz.172, Pz.175, Pz.176, Pz.177, Pz.178, Pz.182, Pz.185, Pz.188, Pz.189, Pz.190, Pz.191, Pz.200, Pz.201, Pz.202, Pz.203, Pz.204, Pz.205, Pz.210, Pz.211, Pz.218, Pz.220, Pz.228, Pz.229.

Kundërthëniet e veprimeve të AK-së i shohim si tendencioze sepse në vlerësimin e parë jemi shpall tenderues i pasuksesshëm ndërsa tani eliminohe mi me arsye të pabazuara dhe të paqëndrueshme.

Në lidhje me këtë arsye të eliminimit sqarojmë se nuk ka bazë ligjore dhe nuk ka asnjë mbështetje faktike për shkak se ne me sqarime i kemi ofruar në detaje çmimet e prodhuesit për pajisje origjinale dhe zbritjet

të cilat na janë ofruar neve.

AK-së vetëm e cek që kemi ofruar Çmime më të larta se sa çmimet e tregut, mirëpo nuk ka dhënë asnjë argument apo dëshmi se cilat janë çmimet e tregut, prandaj mbi këtë bazë rezulton se arsyja e eliminimit është e pa bazuar dhe e pa mbështetur në ndonjë dëshmi konkrete por kjo arsye mbetet vetëm në kuadër të supozimeve të AK-së.

Në treg mund të ketë eventualisht çmime më të lira se sa oferta jonë por ato çmime mund të jenë për pjesë jo origjinale, ndërsa për pjesët origjinale të Toyota nuk ka asnjë mundësi të ketë çmime më të lira se sa oferta jonë.

Pa një analizë të çmimeve të tregut nuk mund të eliminohemi nga konkurrenca dhe atë pa një analizë të mirëfilltë, sepse analiza e çmimeve të tregut nuk mund të jetë krahasuese nëse analizohen çmimet e pjesëve jo origjinale me çmimin e pjesëve origjinale.

AK-së nuk ka blerë asnjëherë pjesë për këtë model të automjeteve, prandaj as nuk janë të njoftuar në detaje me çmimet e këtyre pjesëve.

Çmimet që i kanë parashikua AK-së janë totalisht qesharake dhe ne nuk e dimë se si dhe ku janë bazua kur kanë konstatuar se çmimet tona nuk janë çmime të tregut.

Për modelin Land Cruiser 2.8 DIZEL,204 KF Automatik nuk kanë pas me herët kontratë me tender te hapur dhe nuk i kanë ditur çmimet.

Çmimi që e ka bërë dallimin në 44,694 € në këtë krahasimin e AK-se është shkaku i disa nga pozicionet (PZ 99, 100,101102,105,106,107,112) siç janë Motori, ndërruesit, dhe pjese të ndërruesit, turbina dhe disa kompjuterëve (vetëm këto pozicione bëjnë 63% të diferencës ose në shifër 26,694€).

Sa për të treguar qartë se çmimet edhe për këto pozicione janë çmime të përafërta të tregut ne tani kemi man dëshmi për motoret me vëllim te përafërt 2.7- 3.0 ccm3) origjinale tek VW.

Pasi që në Kosovë nuk ka toyota kemi kërkuar në Toyota Ljubljana në Sloveni.

Bashkangjitur keni ofertat dhe tabelën me çmime.

Nga këto dëshmi kuptohet qartë se oferta jonë është e afërt me çmimet e tregut, por në këtë rast kuptohet se AK-së nuk ka vlerësuar drejtë kur ka përcaktuar vlerën e parashikuar për pozicione të caktuara. Pavarësisht dështimit në herën e parë të këtij tenderi AK-së nuk ka reflektuar për të bërë një analizë reale të çmimeve.

Autoriteti kontraktues nuk ka ofruar asnjë dëshmi përkatësisht ofertë nga ndonjë prodhues apo diler për pjesë origjinale por insiston se çmimet e ofruara nga ne janë më të larta se sa çmimi që e i kanë vendosur ata me rastin e inicimit të aktivitetit të prokurimit, mirëpo nuk dëshmohet e si kanë ardh në këto konstatime.

Për informata po ju rikujtojmë që disa nga automjetet ende janë në Garancion, po edhe nëse është nevojë të blihet nuk ka ku të blihet përveç në TOYOTA, ku në sqarimin e fundit kemi kërkuar të bëjnë një analizë të tregut në Toyote në rajon apo kudo në Evropë.

Ne besojmë që AK nuk ka bërë analizën e duhur të çmimit të tregut, madje Prokurimi nuk ka marrë mundin as të bëjë pyetje në këtë rast ose të bëjë ndryshim të buxhetit nga tenderi i parë i anuluar në Gusht të 2024 me të njëjtin arsyetim.

Referimi në nenin 4.1 pika C të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 nuk përkon me rastin konkret sepse nuk ka asnjë dëshmi që është siguruar autoriteti kontraktues se çmimi i ofruar nga ne është jashtë çmimeve të tregut, prandaj arsyeja e eliminimit është e pa bazuar.

Përkundrazi ne e kemi sqaruar dhe dëshmuar se çmimi i ofruar nga ne është çmim real i tregut, ndërsa nëse AK-së ka pasur vullnet për të vërtetuar këtë fakt shumë lehtë ka mundur të verifikojë çmimin tonë duke kërkuar sqarim edhe nga prodhuesi kudo në Evropë apo rajon, mirëpo një vullnet i tillë ka munguar e që neve na bënë të dyshojmë se veprimet e AK-së janë tendencioze në raport me kompaninë tonë.

AK-së nuk ka shfrytëzuar në mënyrë të drejtë nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së. Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar në të njëjtën ditë kur e kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, pra me dt.21.02.2025, që për neve edhe ky reagim i shpejtë i AK-së është i çuditshëm, kur dihet se AK-së ka shumë aktivitete të tjera dhe ngarkesa. Çmimet e ofruara nga OE janë shumë herë me të larta shprehur edhe ne përqindje për këto pozicionet se çmimet e planifikuara nga njësi kërkuuese të cilat janë bërë ne baze të hulumtimit të tregut.

AK ka kërkuar pjesë të reja me garancion prej 12 muajve sipas kërkesës në dosjen e tenderit për automjetin TYOTA LAND CRUSER 150.

AK ka hartuar specifikat teknike në harmoni me nenin 28 të LPP ku ka kërkuar garancion prej 12 muajve për secilën pjesë të ofruar dhe ky pretendim është shumë i pasaktë.

Ne vijim do ju paraqesim edhe tabelën krahasimeve ku sa janë çmimet e AK dhe ofertës suaj për artikujt e cekur dhe shihni se oferta juaj është shumë here më e lartë se planifikimi i AK dhe ky argument është se AK në harmoni të plot me nenin 471 të rregullores ka eliminuar ofertën tuaj si të papërgjegjshme.

Ne vijim gjeni tabelën krahasimeve mes planifikimit të çmimeve nga ana e AK dhe atyre të ofruara nga OE.

Kësaj përgjigjeje i ka bashkangjitur edhe tabela kinse krahasuese, ku krahasimi i çmimeve tona është bërë kinse me çmimet për njësi të planifikuara nga AK-së.

Krahasimi i tillë nuk mund të jetë i drejtë dhe i saktë sepse ne nuk e dimë se ku janë bazuar autoriteti kontraktues kur ka bërë analizë të çmimeve të tregut por jemi të bindur se nuk kanë bërë analizë të çmimeve të pjesëve origjinale sepse nuk mund të gjenden në treg pjesët të cilat janë cekur me ato çmime që i ka cekur AK-së në këtë tabelë.

Po ashtu arsyetimi i AK-së demantohet kur kemi parasysh faktin se AK-së nuk ka bashkëngjitur asnjë dëshmi se ku janë bazuar kur kanë përcaktuar vlerën e parashikuar, pra nuk ka bashkëngjitur asnjë ofertë apo profaturë të ndonjë prodhuesi apo dileri të pjesëve përkatëse origjinale.

Në fund të tabelës AK-së e ka cekur si më poshtë:

Nëse AK lidh kontratë me këto çmime për sasinë 1 për artikujt larte shënuar do te paguante 44,604.00 euro me shtrenjtë se sa planifikimi i AK

Ky arsyetim i AK-së është plotësisht i pa bazuar, i paqëndrueshëm dhe i pa argumentuar sepse nëse merren pjesë origjinale atëherë nuk ka mundësi të paguhet më shtrenjtë se sa çmimi i tregut, e nëse planifikimi i AK-së është bërë me pjesë jo origjinale atëherë ky fakt është gabim nga ana e AK-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë. Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë edhe në kundërshtim me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “AUTOTRADE” SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në Neni 1 i LPP-së, Neni 6 i LPP-së, Neni 7 i LPP-së, Neni 52 i LPP-së, Neni 59 i LPP-së, Neni 60 i LPP-së, Neni 62 i LPP-së, Neni 72 i LPP-së, Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, Neni 43 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, Neni 4 i Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022. Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP- ja që të merr: VENDIM te APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE AUTOTRADE SH.P.K. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Përgjigjja ne pretendimet ankimore te OE “Autotrade” Sh.p.k.

•AK nuk ka shkelur Nenin 1 Qëllimi i LPP-së , sepse autoriteti kontraktues ka respektuar në tërësi Qëllimin e këtij ligji që është te siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë te shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, dhe të siguroj integritet dhe përgjegjësi të zyrtarëve përgjegjës, transparencë dhe jo diskriminim.

•AK nuk e ka shkelur nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, AK është siguruar se që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ne rastin konkret AK duke mbrojtur fondet publike ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi ju keni çmime shumë herë më të larta se ato reale të tregut.

AK nuk ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo- të LPP-së, pasi të gjithë OE janë trajtuar në mënyrë të barabartë sipas kërkesave në dosjen të tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe specifikave teknike, po ashtu AK nuk ka diskriminuar apo favorizuar asnjë OE përmes kësaj procedure, AK ka hartuar specifikat teknike të cilat janë në harmoni me LPP dhe nuk kanë asnjë kufizim apo favorizim.

AK nuk ka shkelur nenin 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, AK në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ka përcaktuar kriteret kualifikuese dhe kriterin për dhënie të kontratës ku kriter për dhënie të kontratës ka qen Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë, në rastin tuaj ju nuk keni qen i përgjegjshëm pasi ju keni çmime jo reale me ato të tregut

AK nuk ka shkelur nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve dhe neni 40 i rregullores 001/2022, AK ka respektuar në harmoni të plotë nenin 59 të LPP-së pasi ka vlerësuar ekzaminuar dhe krahasuar ofertën tuaj me çmimet reale të tregut dhe me kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ardhur në përfundim se ju keni ofruar me çmime shumë herë më të larta se ato reale të tregut Në harmoni me paragrafin 2 kemi kërkuar sqarime nga ju si OE pjesëmarrës e të cilat sqarime nuk kanë ofruar asnjë dëshmi për ta bindura AK në lidhje me ofertën tuaj financiare e cila është shumë herë më e lart për disa pozicione.

AK nuk ka shkelur nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, AK në harmoni me LPP ka vlerësuar ofertën tuaj të papërgjegjshme pasi ju keni ofruar me çmime më të larta se ato reale të tregut dhe në këtë rast AK ka respektuar nenin 60 në harmoni të plotë.

AK nuk ka shkelur nenin 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit dhe neni 43 i rregullores 001/2022, AK në harmoni të plotë me nenin 62 ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi nuk kemi pasur asnjë ofertë të përgjegjshme sipas kërkesave dhe planifikimeve të AK.

AK nuk ka shkelur nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, AK në harmoni me dispozitat e LPP ka kërkuar sqarime shtesë nga ju si OE në lidhje me çmimet e ofruara nga ana juaj e të cilat informata nuk kanë pasur asnjë bindje për AK në lidhje me çmimet e ofruara.

AK nuk ka shkelur nenin 4.1 pikës C të rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, pasi AK në harmoni me nenin 4.1 pikës C të rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik cila thotë Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shumë herë më të lart se sa çmimet reale të tregut për artikullin.

AK me datën 10.02.2025 përmes letrës standarde ka kërkuar sqarime nga OE ankues për disa pozicione si në vijim:

1.Duke ju referuar neni 4 të rregullores për prokurim publik pikës 4.1 c. Të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut në ofertën tuaj të dorëzuar keni ofruar çmime më të larta, për ta vlerësuar trajtuar drejt ofertën tuaj ju lutem na dërgoni sqarime se si keni ardhur deri tek

formulimi i këtyre çmimeve për pozicionet ne vijim:

Pjesa A: Pz.1, Pz.3, Pz.9, Pz.10, Pz.11, Pz.12, Pz.13, Pz.14, Pz.15, Pz.20.

Pjesa B: Pz.25, Pz.29, Pz.32, Pz.33, Pz.35, Pz.36, Pz.41, Pz.42, Pz.43, Pz.46, Pz.50, Pz.51, Pz.52, Pz.59, Pz.60, Pz.68,89, Pz.90, Pz.99, Pz.100, Pz.101, Pz.102, Pz.105, Pz.106, Pz.107, Pz.112, Pz.113, Pz.114, Pz.129, Pz.132, Pz.133, Pz.135, Pz.137, Pz.140, Pz.141, Pz.143, Pz.144, Pz.145, Pz.147, Pz.148, Pz.150, Pz.154, Pz.157.

Pjesa C: Pz.159, Pz.160, Pz.162, Pz.163, Pz.164, Pz.166, Pz.167, Pz.171, Pz.172, Pz.175, Pz.176, Pz.177, Pz.178, Pz.182, Pz.185, Pz.188, Pz.189, Pz.190, Pz.191, Pz.200, Pz.201, Pz.202, Pz.203, Pz.204, Pz.205, Pz.210, Pz.211, Pz.218, Pz.220, Pz.228, Pz.229

OE me datën 13.02.2025 ka kthyer përgjigje duke ngarkuar çmime te cilat janë shumë here me te larta se ato te planifikuara nga ana e AK.

Çmimet e ofruara nga OE janë shumë herë me te larta shprehur edhe ne përqindje për këto pozicionet se çmimet e planifikuara nga njësia kërkuese t cilat janë bere ne baze te hulumtimit te tregut.

AK ka kërkuar pjese te reja me garancion prej 12 muajve sipas kërkesës ne dosjen e tenderit për automjetin TYOTA LAND CRUSER 150.

AK ka hartuar specifikat teknike ne harmoni me neni 28 te LPP ku ka kërkuar garancion prej 12 muajve për secilën pjesë te ofruar dhe ky pretendim është shumë i pasaktë.

Ne vijim do ju paraqesim edhe tabelën krahasimeve ku sa janë çmimet e AK dhe ofertës suaj për artikujt e cekur dhe shihni se oferta juaj është shumë here ma e larte se planifikimi i AK dhe ky argument është se AK ne harmoni te plot me nenin 471 te rregullores ka eliminuar ofertën tuaj si te papërgjegjshme.

Ne vijim gjeni tabelën krahasimeve mes planifikimit te çmimeve nga ana e AK dhe atyre te ofruara nga OE.

Nëse AK lidh kontratë me këto çmime për sasinë 1 për artikujt e larte shënuar do te paguante 44,604.00 euro me shtrenjtë se sa planifikimi i AK Policia e Kosovës, ne përputhje me nenin 108/A, paragrafi 10.1, refuzon kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 28.02.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0140/2025, ndërsa me datë 12.03.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0140/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE nuk ka dhen përgjigje rreth raportit te ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raportin e ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "AUTOTRADE" SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0140 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit dhe vendimet e AK-së, duke paraqitur konstatimet dhe vlerësimet e tij si më poshtë:

Pretendimi Ankimor 1: Operatori Ekonomik AUTOTRADE SH.P.K. kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) për eliminimin e ofertës së tij, duke e konsideruar të pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore. Fillimisht, AK e shpalli ankuesin të pasuksesshëm, ndërsa pas rivlerësimit e eliminoi me pretendimin se çmimet e tij ishin mbi tregun, pa ofruar një analizë të qartë dhe të verifikueshme për këtë konstatim.

Ankuesi thekson se çmimet e tij janë bazuar në burime zyrtare të Toyota-s dhe për pjesët origjinale nuk ka mundësi të ketë çmime më të ulëta, ndërsa AK nuk ka kryer analizë reale të tregut dhe nuk ka paraqitur prova mbi bazën e vlerësimit të tij. Diferenca prej 44,694 € në krahasimet e bëra nga AK në çmime lidhet kryesisht me pozicione specifike si motori, ndërruesi dhe turbina, të cilat përbëjnë 63% të ndryshimit. Për të dëshmuar vlefshmërinë e ofertës së tij, ankuesi ka siguruar referenca për motorë të ngjashëm nga Volkswagen dhe ofertë nga Toyota Ljubljana.

Ankuesi po ashtu ka theksuar se pavarësisht dështimit të fazës së parë të tenderit, AK nuk ka bërë analizë të mirëfilltë të çmimeve dhe ka krahasuar ofertën e ankuesit me vlera të vendosura nga vetë ai pa një bazë të qartë. Referimi në Rregulloren Nr.002/2024, Neni 4.1, pika C, nuk është i aplikueshëm, pasi AK nuk ka ofruar prova që tregojnë se çmimi i ofertës është më i lartë se çmimi i tregut.

Duke qenë se AK nuk ka kryer një analizë objektive dhe nuk ka ofruar dëshmi për vlerësimin e çmimeve, ankuesi kërkon shfuqizimin e vendimit të eliminimit dhe rivlerësimin e ofertave në përputhje me kërkesat ligjore.

Kronologjia dhe Shkeljet e Konstatuara nga OSHP-ja

Në vlerësimin fillestar të ofertave, AK – Policia e Kosovës rekomandoi për kontratë OE – Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa". Pas këtij vendimi, OE - AUTOTRADE SH.P.K. paraqiti një ankesë pranë OSHP-së, duke potencuar se OE "Buqa" nuk kishte paraqitur autorizimin e prodhuesit, ndonëse ky dokument ishte kriter i përcaktuar në Dosjen e Tenderit (FDT).

Pas shqyrtimit të ankesës, Paneli Shqyrtues i OSHP-së konstatoi se OE "Buqa" nuk e kishte përmbushur këtë kërkesë dhe vendosi që lënda të kthehej për rivlerësim. Në këtë fazë të procesit, AK e vlerësoi OE AUTOTRADE SH.P.K. si të pasuksesshëm.

Në vendimin e tij, OSHP kërkoj nga që AK të kryejë rivlerësimin e ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara në LPP dhe në dokumentet e tenderit, duke siguruar një proces të drejtë dhe të bazuar në prova konkrete.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 1: Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i ankuesit për eliminimin dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit është i bazuar, pasi AK nuk ka kryer një analizë të plotë të çmimeve të tregut, ka referuar njëanshëm çmimet e njësisë kërkuese.

Eksperti vlerëson se, AK është dashur të mbështesë eliminimin e ofertës mbi një analizë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse të tregut, e jo vetëm në çmimet e njësisë kërkuese. Për këtë arsye, eksperti shqyrtues rekomandon që të bëhet rivlerësimi i ofertave, duke siguruar që vendimet mbi çmimet të bazohen në analiza objektive dhe një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Pretendimi Ankimor 2: Shkelja e dispozitave ligjore për transparencë dhe trajtim të barabartë të OE-ve. Ankuesi pretendon se AK ka vepruar në mënyrë të njëanshme dhe diskriminuese, duke mos i trajtuar operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së, i cili kërkon që AK të veprojë në mënyrë të barabartë dhe transparente ndaj të gjithë ofertuesve. Sipas ankuesit AK nuk ka siguruar prova objektive mbi çmimet e tregut për pjesët origjinale Toyota, ka përdorur kriteret e vlerësimit në mënyrë selektive, dhe nuk ka ofruar asnjë informacion mbi bazën e analizës së tij për çmimet e tregut. Ankuesi kërkon shfuqizimin e vendimit të AK-së dhe rivlerësimin transparent të ofertave sipas standardeve ligjore.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 2: Eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentacionin e tenderit në platformën e-prokurimi dhe ka vërejtur dallime në trajtimin e operatorëve ekonomikë nga ana e AK-së. Ndërsa OE "Buqa" ka pasur mundësinë të ofrojë sqarime për disa çmime, të cilat janë pranuar nga AK, për AUTOTRADE SH.P.K., pavarësisht se ka ofruar sqarime në përputhje me kërkesën e AK-së, nuk është aplikuar e njëjta qasje.

Pretendimi ankimor konsiderohet i bazuar, pasi dokumentet e shqyrtuara tregojnë se qasja e AK-së në vlerësimin e operatorëve ekonomikë nuk ka qenë e njëtrajtshme, gjë që mund të ketë ndikuar në objektivitetin dhe transparencën e procesit të vlerësimit.

Dokumentin me analizën e çmimeve të operatorëve ekonomikë, krahasimin me njësinë kërkuese dhe çmimet e kontestuara për AUTOTRADE SH.P.K. të analizuar nga eksperti shqyrtues e gjeni më poshtë:

tabela

Analiza e mësipërme është bazuar vetëm në krahasimin e çmimeve me ato të njësisë kërkuese të gjetura në platformën e-prokurimi. Hijezimet me të kuqe përfshijnë çmimet për të cilat AK kërkoj sqarime nga OE "Buqa" për çmime më të larta se ato të tregut, ndërsa komplet tabela përfshin çmimet të cilat AK i konsideroi më të larta se ato të tregut nga AUTOTRADE SH.P.K. Analiza nuk përfshin verifikim të plotë të çmimeve të tregut apo burimeve alternative të furnizimit, duke lënë hapësirë për nevojën e një vlerësimi më të detajuar dhe gjithëpërfshirës nga AK.

Eksperti shqyrtues sqaron se në vlerësimin fillestar, AK kërkoi sqarime nga OE "Buqa" për çmime më të larta se ato të tregut dhe pranoi arsyetimet e tij. Pas kthimit të lëndës për rivlerësim, AK kërkoi sqarime edhe nga AUTOTRADE SH.P.K., por nuk i pranoi përgjigjet e tij, pavarësisht se ankuesi kishte paraqitur dëshmi dhe kishte kërkuar verifikim nga përfaqësuesit e Toyota-s në rajon ose Evropë.

Kjo qasje e ndryshme në trajtimin e operatorëve ekonomikë mund të krijojë shqetësime lidhur me konzistencën dhe barazinë në vlerësimin e ofertave, në përputhje me Nenin 7 të LPP-së, i cili thekson rëndësinë e trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues.

Sipas ekspertit shqyrtues vlerësimi i ofertave duhet të përfshijë si çmimet jonormalisht të ulëta, ashtu edhe ato të konsideruara të larta, duke garantuar një analizë objektive dhe të argumentuar. Kjo do të sigurojë një proces vendimmarrjeje më të drejtë dhe të bazuar në të dhëna konkrete, duke shmangur çdo mundësi për vlerësim të njëanshëm ose jo të plotë të ofertave.

Në përputhje me Nenin 7 të LPP-së, procesi i vlerësimit duhet të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe të bazohet në analiza objektive.

Pretendimi Ankimor 3: Ankuesi pretendon se procesi i vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk është zhvilluar në përputhje me Nenin 59 të LPP-së, duke mos siguruar një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të tenderëve. Për më tepër, nuk është respektuar kriteri kryesor për dhënien e kontratës, i cili kërkon që ajo t'i jepet operatorit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas Nenit 60, paragrafi 1.1 të LPP-së.

Gjithashtu, ankuesi thekson se anulimi i aktivitetit të prokurimit është kryer në kundërshtim me Nenin 62 të LPP-së, pasi nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë dispozitë për justifikimin e një anulimi të tillë. Në bazë të këtyre shkeljeve, ai kërkon rishqyrtimin e procesit dhe rivlerësimin e ofertave në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 3: Eksperti shqyrtues vlerëson se procesi i vlerësimit dhe krahasimit të ofertave duket të mos jetë zhvilluar plotësisht në përputhje me Nenin 59 të LPP-së, i cili kërkon një shqyrtim transparent dhe objektiv.

Po ashtu, kriteri për dhënien e kontratës operatorit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, siç përcaktohet në Nenin 60, paragrafi 1.1 të LPP-së, duket se nuk është zbatuar në mënyrë të plotë, duke krijuar nevojën për një rivlerësim më të thelluar. Ndërkohë, anulimi i aktivitetit të prokurimit, pa argumente të qarta mbi përmbushjen e kushteve të Nenit 62 të LPP-së, krijon pasiguri lidhur me bazueshmërinë e këtij vendimi.

Duke marrë parasysh këto rrethana, eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor është i bazuar dhe rekomandon rishqyrtim të vendimit, duke siguruar një proces vlerësimi të drejtë dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Pretendimi Ankimor 4: Ankuesi pretendon se vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është marrë brenda një afati jashtëzakonisht të shkurtër, duke ngritur shqetësime mbi seriozitetin dhe thellësinë e shqyrtimit. Sipas ankuesit, kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar më 21.02.2025 dhe AK e ka refuzuar të njëjtën ditë, pa kryer një analizë të plotë.

Sipas tij shpejtësia e vendimmarrjes, në kontekstin e ngarkesës me procedura të tjera të prokurimit, mund të krijojë përshtypjen e një vendimi të paramenduar. Po ashtu, mungesa e një shpjegimi të detajuar mbi argumentet e ngritura në kërkesë e bën këtë vendim të paargumentuar dhe jo transparent.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 4: Eksperti shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar brenda afatit ligjor për t'iu përgjigjur kërkesës për rishqyrtim, siç përcaktohet në Nenin 108/A, paragrafi 7 të LPP-së. AK ka refuzuar kërkesën në të njëjtën ditë, duke respektuar kufirin maksimal prej pesë (5) ditësh pune.

Fakti që përgjigja është dhënë brenda një kohe të shkurtër nuk përbën shkelje, por për të shmangur dyshimet mbi cilësinë e shqyrtimit, AK duhet të sigurojë analizë më të plotë dhe arsyetim më të detajuar për vendimet e saj.

Duke qenë se AK ka respektuar afatin ligjor, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar, por rekomandohet që AK të japë shpjegime më të plota në të ardhmen, për të garantuar një proces më transparent dhe të argumentuar.

PËRFUNDIMI: Eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa e AUTOTRADE SH.P.K. të konsiderohet pjesërisht e bazuar dhe që lënda të kthehet në rivlerësim për një analizë më transparente dhe objektive, në përputhje me dispozitat e LPP-së. Ankesa mbështetet në mungesën e një trajtimi të barabartë mes operatorëve ekonomikë, pasi procesi i vlerësimit nuk është mbështetur në prova të qarta dhe të verifikueshme, duke krijuar pasiguri mbi objektivitetin dhe transparencën e vendimmarrjes. Gjithashtu, eliminimi i ofertës nuk është shoqëruar me një analizë të plotë të tregut, duke ndikuar në bazueshmërinë e këtij vendimi. Megjithatë, pretendimi për shkelje të afateve në shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim nuk mbështetet, pasi AK ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar në LPP. Në bazë të këtyre gjetjeve, eksperti shqyrtues rekomandon rivlerësimin e ofertave dhe sigurimin e një procesi të drejtë, objektiv dhe në përputhje me LPP-në.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues konstaton se ankuesi në këtë aktivitet të prokurimit në bazë të vlerësimeve të vetë AK ka rezultuar se i ka plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, por se i njëjti ka ofruar për pozicione çmime shumë të larta dhe jo në harmoni me çmimin e tregut.

Paneli Shqyrtues konstaton se AK nuk ka kryer një analizë të plotë të çmimeve të tregut e vetmja analize nga ana e AK -së është se janë referuar çmimeve të njësisë kërkuese e cila nuk ka treguar dëshmi se çfarë tregu/servisi ose lideri të pjesëve të autorizuar të tipit Toyota në këtë rast. Po ashtu këto çmime nuk janë dëshmuar se të njëjtat mund të sigurohen nga ndonjë servis i autorizuar i markës përkatëse, sepse edhe hulumtimi i çmimeve të tregut nuk mund të përcaktohet nëse këto pjesë sipas paramasës të sigurohen me shumicë në një servis të caktuar apo të njëjtat janë gjetur/hulumtuar në servise të ndryshme gjë që për arritjen e qëllimit të kësaj kontrate është e pa konceptueshme. Ngase, serviset e ndryshme nuk kanë asnjë lloj garancie për ato shërbime dhe ndoshta edhe staf të kualifikuar ashtu sikurse se kërkon një AK dhe nuk kanë as kosto sikurse një Ofertues në një Tender Publik ku përveç shpenzimeve tjera duhet përfshirë edhe sigurinë e tenderit dhe të ekzekutimit sikurse në këtë.

Po ashtu, vlenë të theksohet fakti se AK ka zhvilluar procedurën e hapur përmes kontratës kornizë me çmime njësi. Kjo për faktin AK nuk i dinë sasi të indikative dhe zhvillimi i kësaj procedure është konform nenit 54.15 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, që do të thotë se në rast se AK me nënshkrimin e këtij lloji të kontratës nuk është e obliguar të paguaj të gjithë vlerën e parashikuar për kontratë si dhe nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar, pa tejkaluar atë. Kjo është mundësuar shumë vonë nga KRPP e cila nxjerr aktet nënligjore sikurse në këtë rast këtë Rregullore të lartcekur vetëm për mos tu dëmtuar autoritetet kontraktuese dhe mos të paguajnë për shërbimet/furnizimet e panevojshme për ndryshim nga e kaluara, ngase sipas kësaj kontrate ka mundësi që shumica e këtyre furnizimeve dhe shërbimeve të mos bëhen fare sepse janë shërbime të cilat bëhen vetëm me porosi dhe në bazë të nevojës së AK, gjë mund të ndodhë që këto lloj kontrata mos të realizohet as 30% e asaj që është kontraktuar. Me këto kontrata më së tepërmi mund të pësojnë OE të cilët ofertojnë dhe nënshkruajnë kontratë me qëllim të realizimit dhe arritjes së vlerës së parashikuar të kontratës, e në fakt mund të mos ndodh.

Andaj, PSH konsideron se në kuadër të një kontrate publike kornizë, operatorët ekonomik gëzojnë mundësinë për të ushtruar lirinë e caktimit të çmimeve për shërbimet dhe furnizimet që ofrojnë, por kjo liri është e kufizuar brenda kornizës ligjore dhe të kushteve të përcaktuara në kontratë. Ky fleksibilitet është një element i rëndësishëm i funksionimit të tregjeve të lira dhe i ofron mundësinë operatorëve për të përcaktuar çmimet e tyre duke pasur parasysh konkurrencën, kërkesat e tregut dhe kushtet e veçanta të kontratës.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj mundësie është se operatorët ekonomik janë të lirë të përcaktojnë çmimet e shërbimeve dhe furnizimeve të ofruara brenda vlerës totale të parashikuar për kontratën. Kjo nënkupton se operatorët mund të shfrytëzojnë lirinë e tregut për të vendosur çmime që përputhen me strategjitë e tyre të biznesit, mundësitë e konkurrencës dhe kostot e ofrimit të shërbimeve, për aq kohë sa ato qëndrojnë brenda kufijve të buxhetit të miratuar dhe kushteve të kontratës. Ky proces i caktimit të çmimeve në kuadër të një tregu të lirë është i mundur pasi operatorët janë duke operuar në një ambient ku mund të përcaktojnë ofertat e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa ndihmën e ndërhyrjeve të drejtpërdrejta nga autoritetet përkatëse.

Operatorët ekonomik duhet të sigurojnë që çmimet e ofruara të jenë të arsyeshme, të bazuara në një vlerësim të drejtë të kostove dhe të mbështetura në parimet e transparencës dhe konkurrencës së lirë, gjë që ankuesi sipas bindjes së këtij Paneli ka ofruar sqarime shumë të qëndrueshme.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe anulimi i procedurës lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIMI ME PJESË PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150 -Ri-tender” me nr. të prokurimit: 214-24-9697-1-1-1, nuk ka mbështetje ligjore konkretisht as mbështetje të nenit 62 të LPP.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, dhe anulon njoftimin mbi vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me “FURNIZIMI ME PJESË PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150 -Ri-tender” me nr. të prokurimit: 214-24-9697-1-1-1, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - " AUTOTRADE " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: